



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	29.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	7737/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1455/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Hamnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Percuku Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës numër A.nr.1455/202, të datës 27.11.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga Mitrovica, kundër organit të punësimit: Komuna e Mitrovicë së Jugut, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1455/2023, e datës 27.11.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Nëpunësi civil [redacted] (tutje vetëm ankuesi), i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 22.11.2023, përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 27.11.2023, kundër listës së datës 01.11.2023, të Komisionit për Klasifikimin e Vendeve të Punës në DMZP-MPB, të dërguar në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, për shkak të: vërtetimit jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovica e Jugut,

ndërsa kjo e fundit, më datë 12.12.2023, ka përcjellë shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e parakohshme, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit me numër protokolli 01-112-27842 të datës 01.11.2013 ushtron pozitën e punës *Zyrtar i gjendjes civil*, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton se ankuesi ka realizuar koeficient gjashtë (6) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në klasën "Profesional 3", me koeficient të pagës Gj 43-3.96/415.80/1.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kategorizimi i ankuseses në klasën Profesional 3 është bërë në mënyrë të gabuar, duke u diskriminuar nga e drejta në pagë dhe vlerësimi në bazë të përgjegjësisë që ka si zyrtar i gjendjes civile, trajtim jo i barasvlershëm me pozitën e punës dhe për pasojë i njëjti është dëmtuar në pagë, propozon që të anulohet pjesërisht lista e komisionit për klasifikimin e vendeve të punës në DMZP-MPB, duke pretenduar se duhet të klasifikohet në klasën Profesional 2.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficientëve, të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë Profesional 2 është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim merititor. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS


Lënda me numër A.nr.1455/2023

Ardita Percuku-SHYTI



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

